

|   |  |                      |
|---|--|----------------------|
|  | <b>RAPORT TREMUJOR</b>                             | <b>DT-PB-002</b>     |
|   | <i>ver. 1.0</i>                                    | <i>faqe 1 nga 47</i> |
| <i>Departamenti Financiar</i>   | <i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i> |                      |

# KOSTT

## Raport për tremujorin e parë 2011

### (01.01.2011-31.03.2011)

|              | <b>Përgatiti</b>   | <b>Kontrolloi</b>  | <b>Aprovoi</b>                     |
|--------------|--------------------|--------------------|------------------------------------|
| Emri Mbiemri | Shpresa Kursani    | Fadil Ismajli KSHE | Kryesuesi i BD<br>Ramadan Paçarada |
| Nënshkrimi   |                    |                    |                                    |
| Data         | <i>Prill, 2011</i> |                    |                                    |

|   |                        |  |
|---|------------------------|--|
|  | <b>RAPORT TREMUJOR</b> | <b>DT-PB-002</b>                                   |
|   | <i>ver. 1.0</i>        | <i>faqe 2 nga 47</i>                               |
| <i>Departamenti Financiar</i>   |                        | <i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i> |

**Raport Tremujor për Bordin e Drejtorëve në KOSTT**  
**Periudha Janar - Mars 2011**

|   |                              |  |
|---|------------------------------|--|
| 1 | <b>Titulli i Dokumentit</b>  | Raport Tremujor 2011   |
| 2 | <b>Dërguesi i dokumentit</b> | Fadil Ismajli, Kryeshef Ekzekutiv  |
| 3 | <b>Përmbajtja e Raportit</b> | <p><b>Kapitulli 1:</b> Pasqyra e strukturës organizative dhe ndryshimet që janë bërë gjatë tremujorit të parë të vitit 2011</p> <p><b>Kapitulli 2:</b> Shqyrtim i performancës afariste dhe financiare</p> <p>2.1. Raport i realizimit të Indikatorëve Teknik të Performancës – operimi i sistemit dhe operimi i transmisionit</p> <p>2.2. Raport i operimit të tregut</p> <p>2.3. Statusi i investimeve (projekteve) kapitale në KOSTT</p> <p>2.4. Çështjet Rregullative</p> <p>2.5. Shqyrtimi i performancës financiare</p> <p>2.5.1. Pasqyrat financiare (Bilanci i Gjendjes dhe Pasqyra e Fitimit/Humbjes, Realizimi i projekteve kapitale nga BK gjatë tremujorit të parë të vitit 2011)</p> <p>2.5.2. Analiza e IKP-ve financiare</p> <p><b>Kapitulli 3 :</b> Përmbledhja dhe përshkrimi i procedurave gjyqësore</p> <p><b>Kapitulli 4:</b> Kontratat/Transaksionet e konsiderueshme gjatë tremujorit të parë të vitit 2011 nga burimet e KOSTT</p> <p><b>Shtojcë 1:</b> Aktivitetet e posaçme</p> |
| 4 | <b>Data e Raportimit</b>     |  |

|   |                        |  |
|---|------------------------|--|
|  | <b>RAPORT TREMUJOR</b> | <b>DT-PB-002</b>                                   |
|   | <i>ver. 1.0</i>        | <i>faqe 3 nga 47</i>                               |
| <i>Departamenti Financiar</i>   |                        | <i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i> |

## Hyrje

Raporti i tremujorit Janar – Mars 2011 është përpiluar bazuar në dispozitën e nenit 31.1 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, ku brenda 30 ditëve pas përfundimit të çdo tremujori kalendarik, zyrtarët e NP-së do të përgatisin një raport për tremujorin e sapo përfunduar (“tremujori përkatës”) i cili i dorëzohet Bordit të Drejtorëve të KOSTT-it për miratim.

Pas aprovimit të këtij Raporti nga Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it, ky Raport do të dërgohet te Njësia për Politikën dhe Monitorimin të NP-ve.

Raporti paraqet rezultate kryesore të aktiviteteve të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve gjatë tremujorit të parë të këtij viti si dhe të aktiviteteve krahasuar me planin vjetor dhe shkallën e realizimit.

Në kapitujt e këtij Raporti, paraqiten të dhënat kryesore për strukturën organizative dhe ndryshimet e bëra, shqyrtimi i performancës afariste dhe financiare, e shprehur edhe me Indikatorët Kyç të Performancës (IKP) teknike dhe financiare, të dhënat rreth operimit të tregut, projektet aktive në KOSTT të paraqitura sipas vlerës, afateve dhe statusit të tyre, procedurat gjyqësore ose të arbitrazhit të pambaruar, transaksionet e konsiderueshme të tremujorit të parë, për të përfunduar me Shtojcën, e cila paraqet funksionimin e qeverisjes korporative të KOSTT-it.

Përbërja e Raportit është identike me përbërjen e definuar në nenin 31.1 të Ligjit Nr. 03/L-087.

|   |                        |  |
|---|------------------------|--|
|  | <b>RAPORT TREMUJOR</b> | <b>DT-PB-002</b>                                   |
|   | <i>ver. 1.0</i>        | <i>faqe 4 nga 47</i>                               |
| <i>Departamenti Financiar</i>   |                        | <i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i> |

## 1. Pasqyra e strukturës organizative dhe ndryshimet gjatë tremujorit të parë 2011

### 1.1. Organizimi

Struktura Organizative aktuale, me ndryshimet e propozuara është aprovuar nga Bordi i Drejtorëve me datën 30 Mars 2011.

Makro Struktura e aprovuar me këto ndryshime ka ardhur si rezultat i kërkesave ligjore nga Ligjit mbi Prokurimin Publik dhe analizave nga menaxhmenti gjatë monitorimit të punës dhe funksioneve të departamenteve përkatëse të KOSTT. Duke u bazuar në këtë, ndryshimet do të ndikojnë në ngritjen e efikasitetit dhe performancës së Kompanisë në përgjithësi, por edhe në performancën e individëve të caktuar në arritjen e objektivave të përcaktuara.

Struktura organizative e KOSTT-it e përbërë nga Bordi i Drejtorëve dhe Menaxhmenti. KOSTT është përcaktuar të ketë një afarizëm të pavarur dhe si i tillë reflekton një fushëveprim bilateral të afarizmit.

Organizimi i KOSTT është bazuar në afarizmin themelor tekniko-operativ, ku mbulohet me Departamentet:

- Operatori i Sistemit
- Operatori i Transmisionit
- Operatori i Tregut

Afarizmi tjetër ka karakter projektues, komercial, rregullativ, ligjor, marrëdhënies me punëtorë, administrativ, zhvillimit të personelit, teknologjisë së informacionit dhe zhvillohet përmes Departamenteve mbështetëse:

- Inxhinieringu dhe Menaxhimi i Projekteve
- Çështjet Ligjore dhe Rregullative
- Financat
- Burimet Njerëzore dhe
- Prokurimit

Në Drejtorinë Qendrore të KOSTT-it janë edhe tri njësi, të emëruara si Zyre, të cilat kanë karakter mbështetës në aspektin e obligimeve financiare, ligjore dhe organizative, që janë:

- Zyra për Zhvillim dhe Planifikim Afatgjatë
- Zyra për Komunikim dhe Relacione me Publikun dhe

|   |                        |  |
|---|------------------------|--|
|  | <b>RAPORT TREMUJOR</b> | <b>DT-PB-002</b>                                   |
|   | <i>ver. 1.0</i>        | <i>faqe 5 nga 47</i>                               |
| <i>Departamenti Financiar</i>   |                        | <i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i> |

- Zyra për Siguri Industriale dhe Mjedis


## 1.2. Numri i Punëtorëve

- Me datën 01 Janar 2011 numri i punëtorëve aktiv në KOSTT ka qenë 213 dhe 1 punëtorë në pushim pa pagesë (pas pushimit të lehonisë), kështu që totali i numrit të punëtorëve ishte 214.
- Me 31 mars 2011 numri i punëtorëve aktiv u rrit në 231 dhe 3 punëtorë në pushim pa pagesë, prej të cilëve 2 punëtorë pas pushimit të lehonisë dhe 1 punëtor tjetër. Totali i numrit të punëtorëve, përfundimisht me 31 mars 2011 ishte 234, që paraqet një rritje të numrit të punëtorëve për 9.3%

Gjatë këtij tremujori kanë filluar punën 20 punëtorë të rinj të pranuar (14 praktikantë dhe 6 punëtorë të rregullt).

Rritja e numrit të punëtorëve do të ketë si rrjedhojë edhe rritjen e shpenzimeve të personelit. Kjo rritje do të ketë ndikim të madh në rritjen e shpenzimeve operative, derisa tarifatat dhe të hyrat e lejuara për vitin 2011, pritet të aprovohen gjatë muajit prill 2011.

Në vazhdim është dhënë Organogrami – Makro Struktura organizative e KOSTT-it, e aprovuar më 30 mars 2011.



|   |                        |  |
|---|------------------------|--|
|  | <b>RAPORT TREMUJOR</b> | <b>DT-PB-002</b>                                   |
|   | <i>ver. 1.0</i>        | <i>faqe 7 nga 47</i>                               |
| <i>Departamenti Financiar</i>   |                        | <i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i> |

## Shqyrtimi i performancës afariste dhe financiare

### 2.1. Raport për operimin e sistemit dhe transmisionit për Indikatorët Teknik të Performancës


#### 2.1.1. Balanca e planifikuar dhe e realizuar për janar- mars 2011

| Muajt  | Janar-Mars 2011 |             |            |
|--|-----------------|-------------|------------|
|  | E planifikuar   | E realizuar | Real/Plan% |
| MWh  |                 |             |            |
| TC Kosova A  | 372 600         | 505 749     | 135.74     |
| TC Kosova B  | 1 030 320       | 1 038 884   | 100.83     |
| HC Ujmani  | 24 000          | 16 960      | 70.67      |
| HC Lumbardhi   | 3 360           | 4 610       | 137.20     |
| Prodhimi gjithsejt   | 1 426 920       | 1 561 592   | 109.44     |
| Devijimi   | 0               | 1 728       |            |
| Eksporti   | 0               | 26 987      |            |
| Importi  | 268 335         | 224 660     | 83.72      |
| Energjia në disponim                                       | 1 695 255       | 1 757 537   | 103.67     |
| Distribucioni  | 1 426 149       | 1 446 257   | 101.41     |
| Ferronikeli  | 167 248         | 160 333     | 95.87      |
| Trepça   | 6 700           | 6 338       | 94.60      |
| Sharri   | 12 200          | 5 225       | 42.83      |
| Mihjet   | 27 000          | 0           | 0.00       |
| Kosova thëngjilli  | 5 100           | 0           | 0.00       |
| Shpenzimet e gjen.nga transm.(LP290,B1,B2,T12,T34,T35,T45) | 0               | 98 994      |            |
| Kërkesa neto   | 1 644 397       | 1 717 147   | 104.42     |
| Humbjet në transmission <sup>1</sup>                       | 50 858          | 40 391      | 79.42      |
| Kërkesa gjithsej   | 1 695 255       | 1 757 537   | 103.67     |

<sup>1</sup> Dallimi i humbjeve të planifikuara dhe të realizuara për periudhën Janar-Mars 2011, është për arsye të sasisë më të vogël të tranzitit të energjisë elektrike (transiti i energjisë nuk planifikohet).


Të dhënat e planifikuara janë marrë nga dokumenti Balanca Vjetore e Energjisë Elektrike 2011, ndërsa të dhënat e realizuara nga pikat matëse dhe të transferuara në kufi të Kosovës.

Të dhënat në tabelë janë ilustruar edhe në diagramin vijues:





## Diagrami i bilancit të realizuar elektroenergjetik Janar-Mars 2011 (GWh)



|   |                        |  |
|---|------------------------|--|
|  | <b>RAPORT TREMUJOR</b> | <b>DT-PB-002</b>                                   |
|   | <i>ver. 1.0</i>        | <i>faqe 10 nga 47</i>                              |
| <i>Departamenti Financiar</i>   |                        | <i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i> |

### 2.1.2. Indikatorët Kyç të Performancës - operimi i sistemit

| Nr | Indikatori                     |        | 2010            | 2011            | 2011/2010(%) | Caku  | Komenti  |
|----|--------------------------------|--------|-----------------|-----------------|--------------|---|--|
|    |                                |        | Janar-Mars 2010 | Janar-Mars 2011 |              |   |  |
| T1 | Energjia e transmetuar (GWh)   |        | 2460,79         | 2405,95         | 97,77        | Nuk mund të vendoset sepse nuk mund të parashihet transiti, e me këte as hyrjet totale në transmision | Caku nuk vendoset për këtë IKP,  |
| T2 | Piku koincident (MW)           |        | 1156            | 1109            | 95,93        | Caku: 1060MW (Sipas: Balanca Vjetore e Energjisë Elektrike 2011).                                     | Caku nuk vendoset për këtë IKP, por shihet që 4,07 % ka qenë piku më i lartë në periudhën Janar-Mars 2010 se sa Janar-Mars 2011.   |
| T3 | Gjatësia totale e linjave (km) | 400 kV | 181,815         | 181,815         | 100,00       | = > 1   | Caku mund të vendoset për çdo vit me ndërtimin e linjave të reja ose riparimin/rindërtimin e linjave të cilat aktualisht nuk janë në operim. Ky cak bazohet në Planin Zhvillimor të Transmisionit. |
|    |                                | 220 kV | 231,882         | 231,882         | 100,00       |   |  |
|    |                                | 110 kV | 672,1085        | 727,6           | 108,26       |   |  |
| T4 | MVA-km                         | 400 kV | 239450          | 239450          | 100,00       | = > 1   | Caku është si në T3  |
|    |                                | 220 kV | 77506           | 77506           | 100,00       |   |  |
|    |                                | 110 kV | 78279           | 80573           | 102,93       |   |  |

|  |                        |  |
|--|------------------------|--|
|  | <b>RAPORT TREMUJOR</b> | <b>DT-PB-002</b>                                   |
|  | <i>ver. 1.0</i>        | <i>faqe 11 nga 47</i>                              |
| <i>Departamenti Financiar</i>  |                        | <i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i> |

|            |  |                    |       |       |        |  |  |
|------------|--|--------------------|-------|-------|--------|--|--|
| <b>T5</b>  | Kapaciteti i transformatorëve                          | 400-220;400-110 kV | 1500  | 1500  | 100,00 | = > 1  | Ky cak mund të vendoset për çdo vit për instalimin e transformatorëve të ri.   |
|            |  | 220-110 kV         | 1050  | 1200  | 114,29 |  |  |
| <b>T6</b>  | Kapaciteti i Disponueshëm Mesatar Import/Eksport(AATC) |                    |       |       |        |  | I paaplikueshëm për shkak që KOSTT nuk është anëtare e ENTSO-E   |
| <b>T7</b>  | Kapaciteti i Disponueshëm Maksimal Import/Eksport MATC |                    |       |       |        |  | I paaplikueshëm për shkak që KOSTT nuk është anëtare e ENTSO-E   |
| <b>T8</b>  | Pagesa për kongjestion                                 |                    |       |       |        |  | KOSTT do të filloj kur ATC do të alokohet nga OT/kontrollohet nga OS për TTC teknike.  |
| <b>T9</b>  | Koha mesatare e ndërprerjes (AIT minuta/vit)           |                    | 22,11 | 25,61 | 115,83 | Caku vendoset sipas raportit: (AIT për periudhen actuale)/(AIT për periudhen e kaluar) < 1 | AIT (Koha mesatare e rënjes) 22,11 minuta gjatë tre muajve Janar-Mars 2010, ndërsa 25,61 minuta për periudhen e njëjtë 2011.   |
| <b>T10</b> | Numri i ankesave për tension                           |                    | 4     | 1     | 25,00  | Nr i përgjigjeve / Nr ankesave = 1   | Caku për ankesa për tension duhet të ndërlidhet me numrin e ankesave në vitin (et) paraprak në periudhen e njëjtë dhe mundësia e zgjidhjes së ankesës duhet të jetë në kohë sa më të shkurtë. Gjatë kësaj periudhe, ka pasur një ankesë për tension, nga |

|  |                        |  |
|--|------------------------|--|
|  | <b>RAPORT TREMUJOR</b> | <b>DT-PB-002</b>                                   |
|  | <i>ver. 1.0</i>        | <i>faqe 12 nga 47</i>                              |
| <i>Departamenti Financiar</i>  |                        | <i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i> |

|            |   |                      |       |       |        |  |   |
|------------|---|----------------------|-------|-------|--------|--|---|
|            |   |                      |       |       |        |  | Ferronikeli.  |
| <b>T11</b> | Ankesat e zgjidhura për tension                               | Më pak se një javë   | 4     | 1     | 25,00  | Nr i përgjigjeve / Nr ankesave = 1             | Caku për zgjidhjen e ankesave për tension duhet të jetë sa më i shkurtër që të jetë e mundur (< 1 javë). Kjo nënkupton që përqindja më e lartë në kategorinë e parë, është më mirë. |
|            |   | Më pak se një muaj   |       |       |        | Nr i përgjigjeve / Nr ankesave = 1             | Caku për ankesa të matjeve duhet të ndërlidhet me numrin e ankesave për vitin(et) paraprak(e).  |
|            |   | Më shumë se një muaj |       |       |        | Nr i përgjigjeve / Nr ankesave = 1             |   |
| <b>T12</b> | Numri i ankesave për matje                                    |                      | 0,00  | 0     |        |  |   |
| <b>T13</b> | Ankesat e zgjidhura për matje                                 | Më pak se një javë   | 0,00  | 0     |        | Nr i përgjigjeve / Nr ankesave = 1             | Caku për zgjidhjen e ankesave për matje duhet të jetë sa më i shkurtër që të jetë e mundur (< 1 javë). Kjo nënkupton që përqindja më e lartë në kategorinë e parë, është më mirë.   |
|            |   | Më pak se një muaj   |       |       |        | Nr i përgjigjeve / Nr ankesave = 1             |   |
|            |   | Më shumë se një muaj |       |       |        | Nr i përgjigjeve / Nr ankesave = 1             |   |
| <b>T14</b> | Vlera mesatare absolute e devijimeve orare Programi (MWh/orë) | Import               | 14,70 | 15,75 | 107,14 | 20MWh/h tërheqje jashta programit të deklaruar | Stafi i Qendrës së Kontrollit ka për qëllim që devijimet mesatare absolute në orë të programeve të importeve/eksporteve të jenë sa më të vogla.                                     |
|            |   | Eksport              | 16,10 | 16,03 | 99,52  | 20MWh/h shtyerje jashta programit të deklaruar |   |

|            |                              |  |       |       |              |  |  |
|------------|------------------------------|--|-------|-------|--------------|--|--|
| <b>T15</b> | Humbjet në transmision (GWh) |  | 40,44 | 40,39 | <b>99,87</b> |  | Humbjet e energjisë elektrike në transmision kanë qenë për 0,13% më të vogla në periudhën Janar-Mars 2010 se sa në periudhën Janar-Mars 2011 |
|------------|------------------------------|--|-------|-------|--------------|--|--|

$$AIT = (8760 * 60 * ENS) / TE$$

ENS-Energy not supplied - EPF-Energjia e pafurnizuar

TE-Transmitted energy - ET- Energjia e transmetuar

AIT- Average interruption time - KMR - Koha mesatare e rënieve

|   |                        |  |
|---|------------------------|--|
|  | <b>RAPORT TREFUJOR</b> | <b>DT-PB-002</b>                                   |
|   | <i>ver. 1.0</i>        | <i>faqe 14 nga 47</i>                              |
| <i>Departamenti Financiar</i>   |                        | <i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i> |

#### 2.1.4. Indikatorët Kyç të Performancës - operimi i transmisionit

| Nr | Indikator  | Niveli i tensionit | 2010        | 2011        | Krahasimi     | Caku  | Komenti              |
|----|--|--------------------|-------------|-------------|---------------|-------|----------------------|
|    |  | kV                 | Janar-Mars  | Janar-Mars  | 2011/2010 (%) | < = 1 |                      |
| T1 | Numri i prishjeve në linja në 100km gjatësi                                    | 400                | <b>0.00</b> | <b>0.00</b> | 0             | < = 1 | Performancë pozitive |
|    |  | 220                | <b>0.00</b> | <b>0.00</b> | 0             |       |                      |
|    |  | 110                | <b>0.46</b> | <b>0.00</b> | 0             |       |                      |
| T2 | Koha mesatare e riparimit të prishjes në linjë(orë)                            | 400                | <b>0.00</b> | <b>0.00</b> | 0             | < = 1 | Performancë pozitive |
|    |  | 220                | <b>0.00</b> | <b>0.00</b> | 0             |       |                      |
|    |  | 110                | <b>3.06</b> | <b>0.00</b> | 0             |       |                      |
| T3 | Koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së linjës (minuta)          | 400                | <b>0.00</b> | <b>0.00</b> | 0             | < = 1 | Performancë pozitive |
|    |  | 220                | <b>0.00</b> | <b>0.00</b> | 0             |       |                      |
|    |  | 110                | <b>0.00</b> | <b>0.00</b> | 0             |       |                      |
| T4 | Numri i prishjeve në transformator në 100 transformatorë (njësi)               | 400/220(110)       | <b>0.00</b> | <b>0.00</b> | 0             | < = 1 | Performancë pozitive |
|    |  | 220/110            | <b>0.00</b> | <b>0.00</b> | 0             |       |                      |
| T5 | Koha mesatare e riparimit të prishjes në transformatorë (orë)                  | 400/220(110)       | <b>0.00</b> | <b>0.00</b> | 0             | < = 1 | Performancë pozitive |
|    |  | 220/110            | <b>0.00</b> | <b>0.00</b> | 0             |       |                      |
| T6 | Koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së transformatorit (minuta) | 400/220(110)       | <b>0.00</b> | <b>0.00</b> | 0             | < = 1 | Performancë pozitive |
|    |  | 220/110            | <b>0.00</b> | <b>0.00</b> | 0             |       |                      |

|  |                        |  |
|--|------------------------|--|
|  | <b>RAPORT TREMUJOR</b> | <b>DT-PB-002</b>                                   |
|  | <i>ver. 1.0</i>        | <i>faqe 15 nga 47</i>                              |
| <i>Departamenti Financiar</i>  |                        | <i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i> |

|     |  |     |             |             |         |          |   |
|-----|--|-----|-------------|-------------|---------|----------|---|
| T7  | Numri i prishjeve në stabilimente të TL në 100 fusha                                   | 400 | <b>0.00</b> | <b>0.00</b> | 0       | < =<br>1 | Performancë<br>pozitive   |
|     |  | 220 | <b>0.00</b> | <b>3.30</b> | 0       |          |   |
|     |  | 110 | <b>0.00</b> | <b>1.20</b> | 0       |          |   |
| T8  | Koha mesatare e riparimit të prishjes në stabiliment (orë)                             | 400 | <b>0.00</b> | <b>0.00</b> | 0       | < =<br>1 | Performancë<br>pozitive   |
|     |  | 220 | <b>0.00</b> | <b>1.00</b> | 0       |          |   |
|     |  | 110 | <b>0.00</b> | <b>2.20</b> | 0       |          |   |
| T9  | Koha mesatare e shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së stabilimentit(fushës)(minuta)    | 400 | <b>0.00</b> | <b>0.00</b> | 0       | < =<br>1 | Performancë<br>pozitive   |
|     |  | 220 | <b>0.00</b> | <b>0.00</b> | 0       |          |   |
|     |  | 110 | <b>0.00</b> | <b>0.00</b> | 0       |          |   |
| T10 | Numri i prishjeve në mbrojtje rele/kontroll në 100 fusha                               | 400 | <b>0.00</b> | <b>0.00</b> | 0       | =1       | Prishja në<br>mbrojtjen<br>distance në LP<br>293/2 në NS<br>Prizreni 2. |
|     |  | 220 | <b>2.77</b> | <b>2.77</b> | 100     |          |   |
|     |  | 110 | <b>3.84</b> | <b>0.00</b> | 0       |          |   |
| T11 | Koha mesatare e riparimit të prishjes në mbrojtje rele/kontroll (orë)                  | 400 | <b>0.00</b> | <b>0.00</b> | 0       | > 1      |   |
|     |  | 220 | <b>4.00</b> | <b>1.70</b> | 235.294 |          |   |
|     |  | 110 | <b>9.33</b> | <b>0.00</b> | 0       |          |   |
| T12 | Koha mesatare shkyçjes për shkak të mirëmbajtjes së mbrojtjes rele/kontrollit (minuta) | 400 | <b>0.00</b> | <b>0.00</b> | 0       | < =<br>1 | Performancë<br>pozitive   |
|     |  | 220 | <b>0.00</b> | <b>0.00</b> | 0       |          |   |
|     |  | 110 | <b>0.00</b> | <b>0.00</b> | 0       |          |   |

|   |                        |  |
|---|------------------------|--|
|  | <b>RAPORT TREMUJOR</b> | <b>DT-PB-002</b>                                   |
|   | <i>ver. 1.0</i>        | <i>faqe 16 nga 47</i>                              |
| <i>Departamenti Financiar</i>   |                        | <i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i> |

## 2.2. Raport mbi operimin e tregut

### 2.2.1. Madhësia e Tregut

Tregu i energjisë elektrike në Kosovë është treg bilateral ku pjesa më e madhe e tregut është rregulluar dhe mungon konkurrenca në tregun me shumicë dhe atë me pakicë. Ekziston vetëm një furnizues që furnizon konsumatorët e rregulluar dhe ata të pa rregulluar.


Të drejtën e konsumatorit të kualifikuar e shfrytëzon Feronikeli por meqenëse nuk ka furnizues tjerë të licencuar Feronikeli është furnizuar nga furnizuesi publik me çmim të parregulluar. Per shkak te mungesës se komkurrencës dhe furnizuesve të tjerë dhe sipas ligjeve te reja lejohet që konsumatori i kualifikuar të furnizohet nga Furnizuesi Publik me çmim të rregulluar i cili ndryshon nga niveli i tensionit ku ata janë të kyçur. Eshte arrite marveshje midis KEK , Feronikelit dhe ZRRë qe Feronikeli te furnizohet nga KEK Furnizimi me cmim te regulluar. në nivelin 220kV.. Prandaj madhësia e tregut që i referohet segmentit të pa-rregulluar do të paraqitet vetem në këtë tremujor si raport i energjisë së konsumuar nga konsumatorët e privilegjuar (kualifikuar) në raport me konsumin e përgjithshëm në Kosovë. Kjo përfshinë energjinë e përgjithshme që ka dalë nga transmisioni dhe energjinë që ka hyrë në distribucion nga Lumbardhi, e cila gjithashtu është pjesë e konsumit.

Konsumi tarifor (pa Feronikelin) në nivel me pakicë në Janar-Mars ‘11 ishte mesatarisht rreth 84.94% të konsumit të përgjithshëm bruto (duke mos përfshirë humbjet në transmision).

Në Fig. 1 është paraqitur figurativisht madhësia e tregut të rregulluar (tarifor) në raport me tregun e parregulluar. Konsumi i KEK nga rrjeti i transmisionit për nevoja vetjake, i cili është i veçantë nga tregu tarifor dhe ai jo-tarifor është i paraqitur gjithashtu në figurë




Fig.1 Tregut tarifor dhe jo tarifor në raport me konsumin



Në Fig 2. është paraqitë bilanci i rrjedhave të energjisë në rrjetin transmetues të KOSTT. Si shihet mbi 23.79% të rrjedhave fizike të energjisë nëpër rrjetin transmetues janë tranzit i energjisë për nevoja regionale, dhe për këtë shërbim KOSTT edhe më tutje nga mekanizmi I ITC nuk është duke u kompensuar por kompensohet EMS ( TSO e Serbisë).

Fig 2. Bilanci i rrjedhave të energjisë në rrjetin transmetues për Janar-Mars 2011  
 Energjia që ka hyrë në rrjetin transmetues    Energjia që ka dalë nga rrjeti transmetues dhe humbjet në transmision



Në Tab. 2 janë dhënë çmimet e rregulluara dhe të parregulluara në tregun e energjisë elektrike në Kosovë. Çmimet e energjisë elektrike të prodhuar në Kosovë janë marrë nga modelet tarifore 2009, 2010, 2011.

Në çmimin mesatar të sistemit ndikon dukshëm sasia e importit dhe çmimi i tij. Si shihet nga tabela çmimi i importit të energjisë elektrike ka pasur rënie dhe si pasojë,

|   |                        |  |
|---|------------------------|--|
|  | <b>RAPORT TREMUJOR</b> | <b>DT-PB-002</b>                                   |
|   | <i>ver. 1.0</i>        | <i>faqe 18 nga 47</i>                              |
| <i>Departamenti Financiar</i>   |                        | <i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i> |

edhe çmimi i ponderuar i energjisë elektrike ka pasur rënie nga viti 2009 deri në vitin 2011.

*Tab. 2. Çmimet e rregulluara dhe të parregulluara energjisë elektrike*

|   |                          | 2009         | 2010         | 2011         |
|---|--------------------------|--------------|--------------|--------------|
|   |                          | €/MWh        | €/MWh        | €/MWh        |
| Çmimet e rregulluara                        | Kosova B                 | 23.32        | 23.35        | 23.35        |
|   | Kosova A                 | 23.32        | 23.35        | 23.35        |
|   | HC Ujmani                | 24           | 27.4         | 27.4         |
|   | HC Lumbardhi             | 40           | 40           | 40           |
| Çmimet e parregulluara                      | Importi - çmimi mesatar  | 75,89        | 57,95        | 63.36        |
|   | Eksporti - çmimi mesatar | 20,17        | 26,45        | 35.73        |
| <b>Çmimi mesatar i ponderuar i sistemit</b> |                          | <b>25,78</b> | <b>24,15</b> | <b>28.45</b> |

|   |                        |  |
|---|------------------------|--|
|  | <b>RAPORT TREMUJOR</b> | <b>DT-PB-002</b>                                   |
|   | <i>ver. 1.0</i>        | <i>faqe 19 nga 47</i>                              |
| <i>Departamenti Financiar</i>   |                        | <i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i> |

## 2.1. Statusi i investimeve (projekteve) kapitale në KOSTT

|   | Projekti  | Buxheti         | Fincuar nga | Vlera e Kontrates | Data e fillimit | Data e kompletimit | Kontraktues  | Realizimi Q1 | Realizimi:<br>(i.) Progresi,<br>(ii.) rreziku dhe pengesat   | Rekomandimet |
|---|---|-----------------|-------------|-------------------|-----------------|--------------------|--------------|--------------|--|--------------|
| 1 | <i>Projekti i Rehabilitimit të NS 220/110 kV – Kosova A</i> | 10,334,070.00 € | BKK / Kfë   | 9,881,052.73 €    | 17.12.2007      | 16.12.2009         | Siemens (At) | 0.00 €       | (i.) Projekti është nën fazën garantuese njëvjeçare, deri më 27.10.2011.<br>Kontraktuesi ka bërë progres në eliminimin e vërejtjeve të komisionit për pranim teknik intern, mirëpo ende mbeten disa vërejtje në cilat kontraktuesi duhet t'i eliminoj të cilat pritet të eliminohen gjatë muajit Prill 2011 të cilat kanë të bëjnë me Dokumentacionin sipas Realizimit (As Build). |              |

|  |                        |   |
|--|------------------------|---|
|  | <b>RAPORT TREMUJOR</b> | <b>DT-PB-002</b>                                    |
|  | <i>ver. 1.0</i>        | <i>faqe 20 nga 47</i>                               |
| <i>Departamenti Financiar</i>  |                        | <i>Spektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i> |

|          |   |                 |           |                            |            |            |                      |        |  |   |
|----------|---|-----------------|-----------|----------------------------|------------|------------|----------------------|--------|--|---|
| <b>2</b> | <p><i>Paket Projekti i NS 400/110 kV – Peja 3 bashkë me Linjat Ndërlidhëse 400 &amp; 110 kV</i></p> | 23.343.233,00 € | BKK / Kfë | 21.562.716,00 € (pa taksa) | 10.06.2008 | 15.03.2010 | Siemens & Umel (B&H) | 0.00 € | <p>(i.) Kontraktuesi ka kompletuar dokumentacionin përfundimtar "as build". Janë liferuar pjesërisht pjesët rezervë për LOT 1 dhe komplet për LOT 2, pjesët tjera të projektit si linjat dhe fushat janë nën periudhën garantuese deri në korrik 2011.</p> <p>(ii.) Mbetet ende e pazgjidhur, çështja e pronësore juridike për ndërtimin e shtyllës nr. 1, të linjës 110 kV, që furnizon NS 110/10(20) kV – Skenderaj.</p> | <p>Për zgjidhjen e çështjes pronësore juridike me pronarin e tokës (shtylla nr.1e LP 110 kV), rekomandohet që autoritetet e Komunës Skenderaj të përgatisin dhe zbatojnë procedurën e shpronësimit, shpallja objekt me interes të përgjithshëm dhe leja ndërtimore është lëshuar nga ta. Rekomandohet menaxhmenti i lartë i KOSTT-it dhe Komisioni për Projekte Kapitale i BD të KOSTT-it të aranzhojnë takim të përbashkët me Kryetarin e Komunës së Skenderajt dhe pronarin e tokës, e tëra kjo pas shumë përpjekjesh të pasukseshme të stafit të Departamentit për M&amp;IP si dhe t'i shkruhet letër zyrtare Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik për përkrahje në këtë drejtim.</p> |
|----------|---|-----------------|-----------|----------------------------|------------|------------|----------------------|--------|--|---|

|  |                        |  |
|--|------------------------|--|
|  | <b>RAPORT TREMUJOR</b> | <b>DT-PB-002</b>                                   |
|  | <i>ver. 1.0</i>        | <i>faqe 21 nga 47</i>                              |
| <i>Departamenti Financiar</i>  |                        | <i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i> |

|          |  |                 |      |                 |            |            |              |        |  |   |
|----------|--|-----------------|------|-----------------|------------|------------|--------------|--------|--|---|
| <b>3</b> | <p><i>Shtërbime<br/>Konsulentësh për<br/>Paket Projektin NS<br/>400/110 kV –<br/>Ferizaj 2 bashkë me<br/>Linjat Ndërlidhëse<br/>400 &amp; 110 kV</i></p> | 700,000.00 €    | ECLO | 668,500.00 €    | 17.12.2009 | 17.10.2011 | INGEDIA (Ro) | 0.00 € | <p>(i.) Gjatë kësaj periudhe raportuese konsulencia, e angazhuar Ingedia nga Komisioni Evropian (ECLO), ka zhvilluar aktivitete në komentimin/aprovimin e dizajneve bazike për të dy LOT-at (për nënstationin NS Ferizaj 2 si dhe për Linjat LP 400 &amp; 110 kV). Janë zhvilluar edhe aktivitete tjera si: Mbajtja e mbledhjeve mujore të progresit, Mbledhjet e Komitetit Drejtues të projektit, Mbledhjet javore; janë mbikçyrur punimet në terren dhe janë dërguar raportet e inspektimit. Lideri i ekipit është larguar për shkaqe shëndetësore, pritet zëvendësimi i tij.</p>  | <p>Është mbajtur edhe një takim i veçant ku iu është rekomanduar në mënyrë strikte që konsulencia të jetë më vigjilente në mbikçyrjen e implementimit të kontratës.</p> |
| <b>4</b> | <p><i>Paket Projekti<br/>Ferizaj-2 <u>LOT-1</u>:<br/>NS 400/110 kV<br/>Ferizaj 2</i></p>   | 15,800,000.00 € | BKK  | 13,656,000.00 € | 24.12.2009 | 23.10.2012 | SIEMENS (At) | 0.00 € | <p>(i.) Kanë filluar punët ndërtimore në terren në fund të muajit Shkurt. Po thuhet të gjitha dizajnet janë aprovuar. Progresi i punëve po shkon me ritëm të mirë, është ndërtuar rrethoja rreth 50%, zyra e terrenit, 40% e murit mbrojtës në mes nivelit të parë dhe të dytë, kanalizimi i përkohshëm si dhe punë tjera sipërfaqësore në gjërmimin dhe ngjeshjen e dheut etj. Janë zhvilluar aktivitete edhe në mbajtjen e Mbledhjeve të Progresit Mujor ato të Komitetit Drejtues, mbledhjet javore të terrenit etj.</p> <p>(ii.) Kontraktuesi ka pasur disa vonesa në fillim për shkak të marrjes së lejeve zyrtare dhe motit gjatë stinës së dimrit, mirëpo pas rishikimit të planit dinamik nga ana e tij është konfirmuar se kjo kohë do të kompensohet dhe se nuk do të ketë vonesa në përfundimin e gjithëmbarshtëm të projektit.</p> |   |

|  |                        |  |
|--|------------------------|--|
|  | <b>RAPORT TREMUJOR</b> | <b>DT-PB-002</b>                                   |
|  | <i>ver. 1.0</i>        | <i>faqe 22 nga 47</i>                              |
| <i>Departamenti Financiar</i>  |                        | <i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i> |

|   |   |                |      |                |            |            |            |        |   |
|---|---|----------------|------|----------------|------------|------------|------------|--------|---|
|   | <i>Paket Projekti<br/>Ferizaj-2 <u>LOT-2</u>:LP ndërlidhëse<br/>400 &amp; 110 kV</i>                      | 7,500,000.00 € | ECLO | 6,105,000.00 € | 31.12.2009 | 30.10.2011 | UMEL (B&H) | 0.00 € | (i.) Projekti është në fazën e punimeve ndërtimore, të cilat deri me tani janë para planit dinamik që është shumë pozitive. Janë përfunduar linjat 110 kV për NS. Bibaj, pjesa e konstruksionit metalik si dhe shtrirja e përqesit, janë mbajtur me rregull të gjitha mbledhjet. Është bërë shpronësimi i tokave me gjithë pronarët e tokave në Komunën e Ferizajt dhe kështu nuk ka probleme për momentin. Është në proces fillimi i shpronësimit të tokave për linjën nga NS Ferizaj 2 – NS Gjilani 5 ku është dorëzuar elaborati për shpronësim dhe në bashkëpunim me Administratat e Komunave nëpër të cilat kalon linja do të fillojnë procedurat për shpronësim. Poashtu janë dërguar kërkesat në KK Viti dhe KK Gjilan për lëshimin e lejeve ndërtimore për pjesën e linjës kah kalon kjo linjë. |
| 5 | <i>Shërbime<br/>Konsulentësh për<br/>Projektin e<br/>Ndërtimit të LP<br/>400kV, Kosovë -<br/>Shqipëri</i> | 1,200,000.00 € | Kfë  | 1,154,620.00 € | 24.09.2009 | 23.05.2010 | INTEC (D)  | 0.00 € | (i.) Kompania konsulente është e angazhuar me procesin e tenderimit të projektit, i cili është në fazën e evaluimit të ofertave të kompanive ofertuese.   |
| 6 | <i>Shërbime<br/>Konsulentësh për<br/>Projektin<br/>SCADA/EMS &amp;<br/>Telekomi</i>                       | 891,541.00 €   | BKK  | 891,541.00 €   | 15.01.2008 | 30.10.2010 | KEMA (D)   | 0.00 € | (i.) Nga ana e stafit të konsulencës së angazhuar, janë zhvilluar aktivitete në menaxhimin dhe mbikëqyrjen e punëve instaluese duke përfshirë edhe pjesëmarrjen në testimet e pajisjeve, si dhe në aprovimin e dizajnit detal për LOT1 si dhe LOT2. Pas takimeve të mbajtura për buxhetin shtesë për konsulencën gjatë muajit Mars është përgatitur dokumenti "Ndryshimi i Kontratës" ( VO 1), për vazhdimësi të kontratës së konsulencës deri në përfundim të projektit SCDA/EMS & Telekomunikacioni në Qershor /2011, pa mjete financiare shtesë, pra është bërë përshtatja e shërbimeve.   |

|  |                        |  |
|--|------------------------|--|
|  | <b>RAPORT TREMUJOR</b> | <b>DT-PB-002</b>                                   |
|  | <i>ver. 1.0</i>        | <i>faqe 23 nga 47</i>                              |
| <i>Departamenti Financiar</i>  |                        | <i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i> |

|   |   |                |     |                |            |            |                     |        |   |   |
|---|---|----------------|-----|----------------|------------|------------|---------------------|--------|---|---|
| 7 | <i>Paket Projekti<br/>SCADA/EMS &amp;<br/>Telekomi<br/>LOT-<br/>1:SCADA/EMS</i> | 8,500,000.00 € | BKK | 7,875,370.00 € | 31.12.2008 | 30.10.2010 | Areva/Komtel (F/KS) | 0.00 € | <p>(i.) Projekti është në fazën e implementimit. Janë duke u vendosur RTU-të nëpër nenstacione të ndryshme, janë evituar mos funksionimet eventuale të pajisjeve të TL nga ana e KOSTT-it, si parakusht për operimin funksional dhe të qendrueshëm të SCADA/EMS. Janë mbajtur takimet e Progresit dhe Komitetit Drejtues. Janë duke u zhvilluar “End-To-End” Testimet për SCS ekzistues si dhe PRE-SAT për RTU. Është mbajtur takimi koordinues me KEK-un rreth PRE-SAT dhe Instalimit të RTU-ve.(ii.) Ka pasur vonesa në realizimin e FAT-it për TS Prizreni 2, vonesa në renovimin në EKCS dhe KCS. Ka probleme në realizimin e punimeve në KCS për shkak të mospunimit të hapësirës përkatëse nga KEK-u, realizimi i punimeve në EKCS për shkak të vendosjes së dyshemesë së dyfishtë. Ka probleme në sigurimin e shkyçjeve të Transformatorëve në TS 110/X kV. Janë vetëm duke u shkyçur linjat për kompletimin e testeve përkatëse. Afati i përfundimit të projektit është 30.06.2011.</p> | <p>Të zgjatet koha e paraparë për testimet nëpër fusha sipas SAT Librit për "End-To_End" Testimet dhe të bëhet presion tek KEK-u për lejimin e shkyçjeve të transformatorëve në TS 110/X kV</p> |
|---|---|----------------|-----|----------------|------------|------------|---------------------|--------|---|---|

|  |                        |  |
|--|------------------------|--|
|  | <b>RAPORT TREMUJOR</b> | <b>DT-PB-002</b>                                   |
|  | <i>ver. 1.0</i>        | <i>faqe 24 nga 47</i>                              |
| <i>Departamenti Financiar</i>  |                        | <i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i> |

|          |  |                |       |                |            |            |                                     |        |   |   |
|----------|--|----------------|-------|----------------|------------|------------|-------------------------------------|--------|---|---|
|          | <i>Paket Projekti<br/>SCADA/EMS &amp;<br/>Telekomi<br/><u>LOT-2: Telekomi</u></i>                            | 9,500,000.00 € | BKK   | 9,214,760.00 € | 31.12.2008 | 30.10.2010 | Enegroinvest/Areva (B&H/F)          | 0.00 € | <p>(i.) Projekti është ne fazen e implementimit. Gjatë kësaj periudhe është vazhduar me komentimin/aprovimin e dizajneve detale për sistemin e Telekomit nga ekipi menaxhues i projektit së bashku me konsulencën. Është bërë komisionimi i rrjetit telefonik VOIP dhe ka filluar instalimi i lidhjeve telefonike në KCS, është mbajtur trajnimi i fundit për mirëmbajtje (at site), në ndërkohë ka përfunduar me sukses SAT për OPGW në relacionin: Prishtina 2 – Prishtina 3 dhe Peja 1 – Peja 2, dhe janë mbajtur Mbledhjet e Progresit Mujorë dhe të Komitetit Drejtues</p> <p>(ii.) Problemi i shpronësimit në Skenderaj ende po pengon mbylljen e linkut optik. Areva ende po vonohet ne dhënien e zgjidhjes për te integruar linkun optik nëntoksorë KCS – Prishtina 3 në konfigurim, për të siguruar “ring protection”. Afati i përfundimit të projektit shte 30.06.2011.</p> | Të insistohet në futjen e linkut optik nëntoksor KCS – Prishtina 3 në konfigurim nga ana e Areva-s, për të siguruar “mbrojtjen unazore”. Në të kundërtën, pa këtë link është e pa realizueshme një gjë e tillë edhe pse është një nga kërkesat kryesore teknike të projektit. Nje gje te tille prietet qe kontraktuesi ta pranoje, konform kushteve te kontrates. |
| <b>8</b> | <i><u>LOT 1 - Furnizimi,<br/>Instalimi dhe<br/>Komisionimi i<br/>ATR3 150 MVA në<br/>NS. Prishtina 4</u></i> | 3,500,000.00 € | KOSTT | 2,214,154.00 € | 16.06.2009 | 15.04.2010 | B Petrol & Electroputere<br>(KS/Ro) | 0.00 € | <p>(i.) Projekti është nën afat garantues deri më 29.08.2011. Në ndërkohë janë realizuar testimet e autotransformatorit (vaji dhe izolimi i pësjtjellave) pas 6 muaj operimi, të cilat kanë dalë të suksesshme.</p>   |   |



|  |                        |  |
|--|------------------------|--|
|  | <b>RAPORT TREMUJOR</b> | <b>DT-PB-002</b>                                   |
|  | <i>ver. 1.0</i>        | <i>faqe 25 nga 47</i>                              |
| <i>Departamenti Financiar</i>  |                        | <i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i> |

|    |   |                         |       |                |            |            |              |        |  |   |
|----|---|-------------------------|-------|----------------|------------|------------|--------------|--------|--|---|
|    | <i>LOT 2 - Furnizimi, Instalimi dhe Komisionimi i Pajis. TL në NS. Prishtina 4</i>  | 800,000.00 €            | KOSTT | 775,202.37 €   | 24.07.2009 | 23.02.2010 | SIEMENS (At) | 0.00 € | (i.) Projekti është nën afat garantues deri më 30.08.2011. Mbetet që kontraktuesi të bëjë eliminimin e vërejtjeve të komisionit për pranim teknik intern dhe të dërgoj dokumentacionin përfundimtar "As Build".  |   |
| 9  | <b>Shërbime Konsulentësh për Projektin e Ndërrimit të Pajisjeve të Tensionit të Lartë në NS Prizreni 2 &amp; Instalimi i ATR3, 150 MVA (LOT1) dhe TI për Operatorin e Tregut (LOT2)</b> | 13,000,000.00€ (LOT1&2) | ECLO  | 634,000.00 €   | 05.10.2010 | 11.07.2012 | INGEDIA (Ro) | 0.00 € | (i.) Ekipi i konsulencës ka filluar me mbikëqyrjen e implementimit të Projektit. Për momentin janë të angazhuar në komentimin/aprovimin e dokumenteve fillestare të projektit pasi që ende nuk kanë filluar aktivitetet në terren si dhe kanë organizuar takimin e parë (kick-off) me kontraktuesit.   | Është mbajtur edhe një takim i veçant ku iu është rekomanduar më mënyrë strikte që konsulencia të jetë më vigjilente në mbikëqyrjen e implementimit të kontratës. |
| 10 | <i>Ndërrimit të Pajisjeve të Tensionit të Lartë në NS Prizreni 2 &amp; Instalimi i ATR3, 150 MVA (LOT1)</i>   | 13,000,000.00 €         | ECLO  | 6,308,920.00 € | 10.01.2011 | 07.01.2014 | KONCAR (CRO) | 0.00 € | (i.) Janë mbajtur takimet fillestare me kontraktuesin (kick-off), ku janë prezantuar detyrat, obligimet dhe synimet lidhur me projektin dhe kontratën. Projekti është në fazën e dërgimit të dokumenteve fillestare për komentim/aprovim, si dizajnet, kompanitë nënkontraktuese, polisat e sigurisë, etj. Është mbajtur një takim në terren për të analizuar planin e punëve, mundësitë e shkyçjeve në nënstacion për të realizuar punët sa më lehtë dhe me shkyçje minimale të furnizimit. |   |

|  |                        |  |
|--|------------------------|--|
|  | <b>RAPORT TREMUJOR</b> | <b>DT-PB-002</b>                                   |
|  | <i>ver. 1.0</i>        | <i>faqe 26 nga 47</i>                              |
| <i>Departamenti Financiar</i>  |                        | <i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i> |

|  |  |  |  |              |            |            |              |        |   |  |
|--|--|--|--|--------------|------------|------------|--------------|--------|---|--|
|  |  |  |  | 834,287.00 € | 10.01.2011 | 09.01.2012 | Siemens (At) | 0.00 € | <p>(i.) Nga ana e kontraktuesit janë mbajtur dy punëtori (workshops), ku i pari kishte për qëllim mbledhjen e informatave aktuale lidhur me funksionimin e tregut dhe i dyti kishte për qëllim prezantimin e një draft-platforme të aplikacionit dhe krahasimi i tij në raport me përmbushjen e kushteve të kontratës.</p> <p>Është mbajtur takimi i Komitetit Drejtues ku është bërë një aprovim preliminar i platformës dhe është mbetur që të sigurohen edhe disa të dhëna shtesë.</p> |  |
|--|--|--|--|--------------|------------|------------|--------------|--------|---|--|

|   |                        |  |
|---|------------------------|--|
|  | <b>RAPORT TREMUJOR</b> | <b>DT-PB-002</b>                                   |
|   | <i>ver. 1.0</i>        | <i>faqe 27 nga 47</i>                              |
| <i>Departamenti Financiar</i>   |                        | <i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i> |

## **Çështjet Rregullative**

### **1. Shqyrtimi i Pestë i Tarifave të Energjisë Elektrike**

Përmes shkresës të datës 30 dhjetor 2010, KOSTT është njoftuar nga ZRrE lidhur me planin e realizimit të Shqyrtimit të Pestë të Tarifave të Energjisë Elektrike (SHTE5), që ka të bëjë me tarifat dhe ngarkesat e reja që do të hyjnë në fuqi dhe do të zbatohen nga data 1 prill 2011.

Në bazë të parimeve dhe orarit për shqyrtimin tarifor të përcaktuar nga ZRrE, me datë 28 janar KOSTT ka dërguar në ZRrE aplikacionin e përgatitur me të gjitha të dhënat dhe arsyeshmërinë për të hyrat e lejuara për periudhën e shqyrtimit të pestë tarifor në Modelin Tarifor, përgatitja e arsyeshmërisë etj.

Me datë 08 shkurt KOSTT ka dërguar në ZRrE disa plotësime shtesë lidhur me aplikacionin e dërguar të datës 29 janar.

Me datë 22 shkurt KOSTT ka pranuar nga ZRrE dokumentin Raporti Konsultativ për KOSTT sh.a dhe për KEK sh.a. lidhur me Shqyrtimin e Pestë të Tarifave të Energjisë Elektrike.

Sipas orarit të caktuar nga ZRrE, me datën 04 mars KOSTT ka dërguar në ZRrE komentet ndaj Raportit Konsultativ.

### **2. Inicimi i Kontestit ndaj KEK sh.a.**

Me datën 09 shkurt 2011 KOSTT ka iniciuar kontestin ndaj KEK sh.a.

Ne kontest janë paraqitur arsyet e ankesës si në vijim:

#### **Arsyet e Ankesës:**

- a) Refuzimi i pagesës për shërbimet e transmisionit dhe kthimi i faturave për muajin nëntor dhe dhjetor të vitit 2010 nga ana e KEK-ut;
- b) Mosnënshkrimi i KEK-ut i Marrëveshjes për Kyçje me KOSTT-in;
- c) Mospagesë e faturave të rekoncilimit për vitin 2008 dhe 2009 të dërguar nga KOSTT-i.

|   |                        |  |
|---|------------------------|--|
|  | <b>RAPORT TREMUJOR</b> | <b>DT-PB-002</b>                                   |
|   | <i>ver. 1.0</i>        | <i>faqe 28 nga 47</i>                              |
| <i>Departamenti Financiar</i>   |                        | <i>Sektori: Planifikimi Strategjik dhe Buxheti</i> |

## 2.5. Shqyrtimi i performancës financiare -

### 2.5.1. Draft Pasqyrat Financiare: BILANCI I GJENDJES

#### BILANCI I GJENDJES \_31.03.2011

|  | Nota | Janar-Mars<br>/2010 | Janar - Mars 2011  | %              |
|--|------|---------------------|--------------------|----------------|
| <b>ASETETE JO QARKULLUESE</b>              |      | <b>75,731,504</b>   | <b>87,487,319</b>  | <b>115.52%</b> |
| Prona, Fabrika dhe Paisjet                 | 4    | 61,661,868          | 68,695,319         | 111.41%        |
| Investimet në vijim                        | 5    | 14,069,637          | 18,792,000         | 133.56%        |
| <b>ASETET QARKULLUESE</b>                  |      | <b>30,683,323</b>   | <b>35,803,047</b>  | <b>116.69%</b> |
| Stoqet,pjesët rezervë dhe veglat           | 6    | 884,084             | 916,337            | 103.65%        |
| Kërkesat                                   | 7    | 12,144,304          | 10,032,777         | 82.61%         |
| Kredi,Avanse dhe Depozita                  | 8    | 8,255,879           | 6,890,671          | 83.46%         |
| Tatimi i Parapaguar                        |      | -                   | 135,417            | 0.00%          |
| Paraja dhe Bilanci Bankar                  | 9    | 9,399,056           | 17,827,846         | 189.68%        |
